

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 61 paragrafi 3 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 5 paragrafi 1 dhe nenit 6 paragrafi 2 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.03/2023 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna, nenit 13 paragrafi 1 dhe nenit 35 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e dytë të jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 30.12.2025, merr këtë:

V E N D I M Nr.58/2025/KG
për emërimin e nënkryetarit të komunës për komunitete

Neni 1

EMËROHET Leutrim Ajeti në postin e nënkryetarit të Komunës së Graçanicës për komunitete.

Neni 2


Nënkryetari i komunës për komunitete nga paragrafi 1 i këtij Vendimi do të emërohet për periudhën deri në skadimin e mandatit të kryetarit të Komunës së Graçanicës, me mundësi të shkarkimit të mëhershëm.

Neni 3

Nënkryetari i komunës për komunitete është i detyruar që t'i kryejë detyrat e tij në përputhje me Ligjin nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, Udhëzimin administrativ (MAPL) nr. 03/2023 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna, Statutin e Komunës së Graçanicës (nr. 6320/15 i datës 22.10.2015) dhe aktet e tjera ligjore.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.


Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević